Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-542 Datë: 30.07.2025

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Udhëzimit Administrativ të (MASHT) nr.09/2019 për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2025 merr:

V E N D I M

I. **Akreditohet dhe validohet** "Eurometal Academy", adresa: "Babush i Ri", magjistralja Ferizaj - Prishtinë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.06.2025 deri më 31.05.2028, me kualifikimin: **"Salduesit dhe Prerësit me Flakë"**, niveli IV sipas KKK-së, me 23 kredi të AAP. Kualifikim i bazuar në: **Kualifikime Kombëtare Profesionale (D).**

1. **"Eurometal Academy"** mund të certifikojë me kualifikim të plotë deri në dy (2) grupe, secili me nga 12 kandidatë, në total 24 kandidatë në vit.

2. **"Eurometal Academy"** mund të certifikojë me kualifikim modular, sipas ndarjes logjike të moduleve, deri në 7 grupe me nga 12 kandidatë secili, në total 84 kandidatë në vit.

II. Obligohet Institucioni të plotësojë kushtet bazuar në vendimet e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Institucioni mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

ARSYETIM

Në bazë të kërkesës së kolegjit "Eurometal Academy", të parashtruar në AKK, për akreditim dhe validim të institucionit "Eurometal Academy" për kualifikimin: "Salduesit dhe Prerësit me Flakë", niveli IV i KKK. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe fushëveprimtarinë e AKK-së, ka caktuar ekipet e ekspertëve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim.

Ekipi i ekspertëve, pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit më 18.04.2025 për kualifikimin **"Salduesit dhe Prerësit me Flakë"**, niveli IV, dhe vizitës së realizuar më 23.04.2025, pas përfundimit të procesit vlerësues, ka përpiluar raportet më 07.05.2025. Bazuar në analizën e dosjes së aplikimit dhe gjetjet gjatë realizimit të vizitës, si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve, çështja është proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 25.07.2025.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve mbështeten në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit, si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, si dhe gjetjet gjatë realizimit të vizitave tek pala aplikuese.

AKK, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 për kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, është e obliguar të realizojë procesin e monitorimit dhe të raportojë tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, në bazë të kërkesës së institucionit "Eurometal Academy" për akreditim dhe validim, si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, të gjeturave në raportet vlerësuese dhe nga të lartpërmendurat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

AKK, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014, për kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, është e obliguar të realizojë procesin e monitorimit dhe të raportojë tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, në bazë të kërkesës së institucionit "Eurometal Academy" për akreditim dhe validim, si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, të gjeturave në raportet vlerësuese dhe nga të lartpërmendurat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë për rishqyrtim të vendimit, sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, për kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ dorëzohet në Këshillin Drejtues të AKK-së, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit

Vendimi u dërgohet:

- Institucioni "EUROMETAL ACADEMY"
- Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve